



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, datë 01/03/2021

### **Komunikatë për Shtyp**

Në përgjigje të komunikimit të rremë të përcuar nga adresa të rreme e-maili të fabrikuar si komunikime zyrtare, njoftojmë që Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural operon në funksion të ligjeve të shtetit Shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me Bashkimin Evropian duke bashkërenduar punën me institucione që auditojnë, kontrollojnë përdorimin e fondeve sipas rregullave të Bashkimit Evropian.

OLAF është vetëm një nga strukturat monitoruese/kontrolluese të përdorimit efektiv të fondeve të Bashkimit Evropian si për vendet anëtare dhe vendet e paraaderimit IPA. Fondet administrohen në përputhje me Marrëveshjen Kuadër të ratifikuar me Ligj 37/2015, datë 9.4.2015 dhe Marrëveshjen Sektoriale të ratifikuar me Ligj nr. 30/2016 datë 17.3.2016, sipas manaxhimit indirekt dhe të decentralizuar. Institucionet Shqiptare e kanë marrë besimin për zbatimin e Programit IPARD në vitin 2018 dhe kësaj monitorohen nga strukturat e Bashkimit Evropian për efektivitetin e administrimit të fondeve në përputhje me objektivat e programit.

Mesazhi i përcjellë përmes adresave të rreme, është gjithashtu i rremë. AZHBR është në bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturat e ndryshme të monitorimit të Bashkimit Evropian për të adresuar çdo pretendim të ngritur nga përfitues apo aplikues në programet tona.